



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

PROJEKT

RREGULLORE

PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË RREGULLORES PËR SIGURINË NË PUNË,
SHËNDETIN DHE MJEDISIN E PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL KOMUNAL

Gjilan, qershor 2014

Në bazë të neneve 11, 12 par. 12.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008), nenit 39 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 të dt. 06.11.2014 dhe në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e vetë të mbajtur me datën _____2014, miratoi këtë:

R R E G U L L O R E
PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË RREGULLORES PËR SIGURINË NË PUNË,
SHËNDETIN DHE MJEDISIN E PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL TË KOMUNËS

Neni 1.

Te rregullorja bazë, emërtimi i rregullores ndryshohet dhe ka këtë përmbajtje:
“Rregullore për Pajisjet Personale Mbrojtëse në Punë”.

Neni 2.

Neni 1 i rregullores bazë, ndryshohet dhe ka këtë përmbajtje: ”Me këtë rregullore përcaktohen pajisjet personale mbrojtëse në punë me qëllim të përmirësimit të shkallës së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve në punë në shërbimin civil komunës së Gjilanit”.

Neni 3.

Nenet 2 deri në 32 të rregullores bazë, fshihen.

1. Neni 33 paragrafi 1 i rregullores bazë, ndryshohet dhe ka këtë përmbajtje: “Në kuadër të përgjegjësive të tij, punëdhënësi (komuna) për vendet e punës në pajtim me ligjin dhe këtë rregullore detyrohet të caktoj pajisjet personale mbrojtëse (PPM) si masë për siguri dhe shëndet në punë”.
2. Neni 33 paragrafi 2 i rregullores bazë, ndryshohet dhe ka këtë përmbajtje: “Lista e pajisjeve personale, mbrojtjes (PPM) për vendet e caktuara të punës në shërbimin civil komunal është si në vijim:”.
3. Neni 33 paragrafi 3 i rregullores bazë, ndryshohet dhe ka këtë përmbajtje: “Në vendet e punës ku është e detyrueshme mbajtja e uniformës së punës duhet të figuroj mbishkrimi i institucionit (përkatësisht, drejtorisë përkatëse)”.

Neni 4.

Neni 34 i rregullores bazë, fjala “0.5” zëvendësohet me “1”.

Neni 5.

Neni 35 dhe 36 i rregullores bazë, fshihen.

Neni 6.

Neni 37 paragrafi dhe 2 i rregullores bazë, ndryshohet dhe ka këtë përmbajtje: “Punëdhënësi (Komuna) obligohet që me mjetet e veta të sigurojë pajisjet personale mbrojtëse (PPM) siç janë të parapara me këtë rregullore”.

Neni 7.

Neni 38 i rregullores bazë, fshihet.

Neni 8.

Neni 39 i rregullores bazë, ndryshohet dhe ka këtë përmbajtje: “Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në web faqen e Komunës”.

Neni 9.

Pas miratimit të kësaj rregulloreje duhet të bëhet hartimi i tekstit të spastruar të rregullores aktuale në fuqi.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01. nr. _____
Gjilan, më _____

Kryesuesja;
Valentina Bunjaku-Rexhepi

A r s y e t i m i

- Me miratimin e Ligji Nr. 04/L-161 datë 16 maj 2013 për sigurinë dhe shëndetin në punë janë përcaktuar masat për përmirësimin e shkallës së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve në punë, dhe meqenëse ligji nuk ka obliguar punëdhënësit që miratojnë rregulla që prekin këtë fushë, janë plotësuar kushtet ligjore që të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për Sigurinë në Punë, Shëndetin dhe Mjedisin e Punës në Shërbimin Civil Komunal.
- Andaj bazuar në dispozitat e cituara në arsyetim dhe në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/ L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008 dhe nenit 80 paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 16-531256 i datës 11.11.2011, në emër të Kryetarit të Komunës propozojë:

PROJEKT-RREGULLOREN PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM E RREGULLORES PËR SIGURINË NË PUNË, SHËNDETIN DHE MJEDISIN E PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL KOMUNAL

- Me këtë projekt-rregullore, nga rregullorja aktuale në fuqi eliminohen dispozitat të cilat rregullojnë fushën e shkallës së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve sepse me miratimin e Ligji Nr. 04/L-161 datë 16 maj 2013 për sigurinë dhe shëndetin në punë nuk ka obliguar punëdhënësit që të miratojnë rregulla që prekin këtë fushë sepse e tëra është rregulluar me ligj, me përjashtim rregullimit të çështjes së pajisjes me mjete personale mbrojtëse që i lihet në kompetenca punëdhënësve.
- Bazuar në dispozitat e sipërcituara propozohet miratimi i këtij projekt-rregulloreje që përcakton Pajisjet Personale Mbrojtëse në Punë për të cilat është kompetentë punëdhënësi ti sigurojë për një kategori të caktuar të punëtorëve varësisht nga natyra e vendit të punës mund të jetë i rrezikuar shëndeti i tyre.
- Në kuptim të kësaj që përmend në arsyetim të këtij projekti të rregullores kërkojmë të miratoni ndryshimet dhe plotësimet në rregulloren aktuale në fuqi.